



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prinjeto Më/Dana 01-02-2024 vit/ed			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetës Prilog	Vlera Vrednues
01-	060/01-		118



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026 të Komunës së Vitisë,  
Vendimi me Nr.01-110/05-163, i datës 01.03.2023

### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026, Vendimin Nr. 01-110/05-163, të datës 01.03.2023.

### Neni 2

Shfuqizimi i vendimit për miratimin e planit bëhet për arsye se, ky dokument nga instruksionet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit është rimodeluar sërish dhe hyn në fuqi vetëm me nënshkrimin e kryetarit të Komunës, pa pasur nevojë miratimin e Kuvendit të Komunës.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës së Vitisë.

### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

